

**KOLEC TOPALLI****DISA VEÇORI ARKAIKE NË VEPRËN E DE RADËS**

De Rada është poeti më i madh arbëresh dhe njëri prej klasikëve të letërsisë shqiptare, njëkohësisht publicist e filolog, folklorist e veprimtar, figurë qendrore e Rilindjes sonë kombëtare. Emri i tij është i lidhur me njërën nga periudhat më të vështira, por edhe më të lumnueshme të Italisë e të Shqipërisë, meqenëse ai luftoi për të dy këto vende. E ka nisur veprimtarinë e tij kur lëvizja e Rilindjes Shqiptare ishte ende në hapat e saj të parë dhe për 70 vjet me radhë qe shpirti frymëzues i saj. Ai ka qenë një përfaqësues i denjë i ndërgjegjes dhe i rizgimit kombëtar të shqiptarëve, një simbol sakrifice për Atdhe e Liri, një rreze shprese që po lindte për një Shqipëri të lirë e të pavarur.

Vepra e tij është një kontribut i çmuar edhe për historinë e shqipes. Në të gjejmë fjalë, shprehje, trajta e konstrakte, që pasqyrojnë një stad më të hershëm të gjuhës; si rrjedhim, ato kanë një rëndësi të veçantë për studimin e historisë së saj. Nga kjo anë, interesi që paraqesin veprat e poetit më të madh arbëresh për studimin e historisë së shqipes e ka burimin në faktin se ato janë shkruar në dialektin arbëresh, që ka ruajtur mjaft tipare arkaike, për arsye të shkëputjes së tij që në shekullin XV nga trungu i gjuhës-nënë. Kësaj duhet t'i shtohet fakti se De Rada ka pasur një frymëzim spontan, gjë që e bën veprën e tij një pasqyrë mjaft besnike të së folmes së vendlindjes dhe të krahinës përreth.

Kontributi që paraqet vepra e De Radës për studimin e historisë së shqipes mund të shqyrtohet në disa aspekte. Nga ana leksikore, De Rada përdor mjaft fjalë të vjetra, arkaizma, që zgjojnë interes për etimologjinë e tyre<sup>1</sup>. Në aspektin fonetik, poeti nxjerr në dritë tipare dialektore, që i gjejmë edhe në treva të tjera ku flitet shqipja, tek arbëreshët dhe në viset përkatëse Adriatikut, më shumë në vise jugore por nganjëherë edhe në vise veriore, si rezultat i përzierjes së emigrantëve nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Një interes të veçantë paraqesin sidomos disa trajta gramatikore, që kanë qenë të gjalla në një fazë të hershme të shqipes dhe janë ruajtur në veprën e poetit të madh. Si trajta arkaike, ato i kanë edhe autorët e vjetër ose gjenden nëpër të folme dialektore; si rrjedhim, një vështrim i tyre në plan krahasimtar ndihmon për të skicuar kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të shqipes në periudha më të hershme të zhvillimit të saj.

---

<sup>1</sup> E. Çabej, *Në botën e arbëreshëve të Italisë*, Tiranë, 1987, 37 v.

Për sistemin emëror, vëmë në dukje ruajtjen e gjinisë asnjane, në emra që sot kanë kaluar në gjini të tjera; si *ballë, krye, ujë, rrush* etj.; p.sh. *Ngrëjti ballët e shuljuar; Pruar e uli kriethit; gjith kaqë ata uj; rrusht i dha të lamahjurve*. Siç dihet, kjo gjini ka qenë më e gjallë para disa shekujsh, por ka ardhur duke u rruddhur gradualisht, aq sa sot kanë mbetur pak emra të tillë. Në këtë pikë De Rada dëshmon një tipar të shqipes së lashtë, që e pasqyrojnë edhe autorët e vjetër të letërsisë shqipe<sup>2</sup>. Një trajtë tjetër arkaike që gjendet në veprat e De Radës, është një trajtë e kallëzores së shquar me mbaresën *-t*, që shoqërohet gjithnjë me një parafjalë, një formë rasore e krijuar përbrenda shqipes në një periudhë më të hershme se fillimet e shqipes së shkruar, të cilën e kanë pasur të gjitha të folmet, por sot ka mbetur vetëm në përdorime dialektore<sup>3</sup>. De Rada e përdor atë mjaft dendur; p.sh. *Ndë çerët e dhezurës; Uj të rī ndë dejtīt; Si drita ndë qiellit*. Një trajtë tjetër rasore arkaike që përdor De Rada është gjinore-dhanorja shumë me mbaresën e vjetër *-et* me emrat që mbarojnë me një bashkëtingëllore; p.sh. *shpīt e njerëzet; E garruam vëllezëret; Komini i Topenjet*. Në shqipen e sotme kjo trajtë rasore përdoret me mbaresën *-ve*, ku bashkëtingëllorja *-v-* ka ndërhyrë në fillim tek emrat që mbarojnë me zanore dhe më vonë është shtrirë në ata që dilnin me bashkëtingëllore. Në forma të tilla De Rada ruan edhe një tipar tjetër: njëjën *-t* në trajtën e shquar, e cila në shqipen e sotme ka rënë e nuk përdoret më; p.sh., *Shkundi borën e fushavet; E rëmpiem gjithonevet; Friti ër e malevet*. Shpeshherë De Rada përdor trajtën e vjetër të rrjedhores së shquar shumë me mbaresën *-shit*; si: *Dielli i sqepur reshīt; Shpejt edhe pra duarshīt t'ona*. Edhe kjo formë, që ka dalë jashtë përdorimi në shqipen e sotme, ka qenë e gjallë te autorët e vjetër, si Buzuku, Matrënga etj. duke ardhur përdorimi i saj deri në periudhën e Rilindjes. Gjejmë, gjithashtu, gjurmë të një paradigme lakimi të emrave femërorë, që dilnin me mbaresën *-ja* në trajtën e shquar; si p.sh. *e bashk dërgon të fala shëndetës të katundit*. Në shumësin e emrave, janë për t'u vënë në dukje disa trajta metafonike, si: *shtrete, kuel, rehe*, si p.sh. *të shprishta ndër shtrete*<sup>4</sup>; *Gjegji kuel se hinkëlin*<sup>5</sup>; *çë more rehet?*, duke u shtrirë kjo dukuri analogjiksht edhe në klasën e mbiemrave; p.sh. *Dushqe të lert rrëjin te rēt*.

Për sistemin përemëror, De Rada përdor trajtën e vjetër *u* të vetorit *unë*; p.sh. *U pushonj ndë kët dimër; u të më shoh; O e shkreta u*. Kjo trajtë, që e ka edhe Buzuku, ruhet edhe sot në krahinat e Veriut të Shqipërisë, si edhe në të

<sup>2</sup> E. Çabej, *Histori gjuhësore dhe strukturore dialektore e arbërishtes së Italisë*, SF, 1975/2, f. 59.

<sup>3</sup> K. Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, 397 v.

<sup>4</sup> E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967, 97.

<sup>5</sup> Këtë trajtë metafonike e ka edhe Kosova.

folme anësore të Jugut<sup>6</sup>. Përemrin *kjo* e përdor në trajtën e vjetër me zanoren -*ë* të ruajtur; p.sh. *Kā m'erith te kurmi gjith këjo gadhī*. Por përkundrejt këtyre formave të ruajtura, De Rada ka edhe forma të evoluara të përemrave dëftorë, ku ka rënë zanorja e rrëguar, ashtu si në gegërishten e sotme; p.sh., *Cëgjohet e ndë kët gjëll; At dit më rri me mäll; U pushonj ndë kët dimër*. Përemrin e pacaktuar *tjetër* e ka ruajtur në trajtën e tij të thjeshtë pa përngjitje të nyjës, që është edhe forma më e vjetër; si p.sh. *Kalli jetërën te gjiri; ruan nj'ill e jetërin*. Edhe *kjo* trajtë, që është zhdukur në shqipen e sotme, gjendet në veprën e Buzukut<sup>7</sup>. Një tjetër përemër, që ka ruajtur formën më të vjetër, është vetvetori *vetëhe*; p.sh., *Vate tha me vetëhën; Besën e kân mbī vethën; E ktu vetëhën time*. *Kjo* trajtë e lashtë përemri gjendet në veprat e të gjithë shkrimtarëve të vjetër gegë e për nga forma pajtohet sidomos me trajtën e të folmeve të Jugut: çam. *me vet'he, për vet'he*.

Në sistemin foljor, janë për t'u vënë në dukje disa forma arkaike, që janë zhdukur në shqipen e sotme, por janë ruajtur të gjalla në disa të folme anësore. Në trajtat e së tashmes, është ruajtur mbaresa e vjetër *-nj*; si p.sh. *t'i frinj ajrin*. Paradigma e zgjedhimit të foljeve në *-mi*, që në shqipen e sotme e kanë ruajtur vetëm foljet *jam, kam* e *them*, në veprat e De Radës ka një shtrirje më të madhe, duke përfshirë edhe folje të tjera; si p.sh. *na ju ruami; Pas vëdekur, tha, na rromi; mbi anī shkomi detin*. Një mbaresë tjetër e foljeve në të tashmen është *-ën*, që në shqipen e sotme e marrin pak folje njërrokshe, si *ikën, ecën, hipën.*, kurse në veprën e De Radës ka shtrirje më të madhe, si p.sh. *Ajo e gjegjën; Lulevet çë tundën era*<sup>8</sup>. Edhe *kjo* paradigmë foljore, që është një zhvillim i brendshëm i shqipes, ka qenë mjaft e gjallë para disa shekujsh, sikurse e dëshmon edhe Buzuku dhe autorë të tjerë; por ajo ka ardhur duke u rrudhur, sa kanë mbetur vetëm disa gjurmë të saj në gjuhën e sotme. Në trajtën joveprore, ka raste kur ajo është formuar drejtpërdrejt nga trajta veprore, duke hyrë në përbërjen e saj edhe mbaresa; si p.sh. *E zëgjonem e garepsur; Mos zgjonet mëma*. Këto trajta janë të pranishme në veprën e Buzukut dhe në disa të folme anësore të Jugut të Shqipërisë, sidomos në çamërishte. Më të larmishme janë nga *kjo* anë format e së pakryerës, sidomos në vetën e tretë numër njëjës, që del pa mbaresë, sepse mbaresa *-te* është relativisht e re. Kësisoj, De Rada ruan format më të lashta kur atyre nuk u ishte ngjitur mbaresa; si p.sh. *Çë mi dil tek udha e lumit*. Edhe këto forma i kanë autorët e vjetër të Veriut dhe e folmja e çamërishtes në Jug. Një përdorim të dendur ka edhe një trajtë tjetër e së pakryerës me mbaresën *-ej*, që është e njëjtë me mbaresën e trajtës joveprore; p.sh. *Por lumbārdh e*

<sup>6</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, 447.

<sup>7</sup> Buzuku: *Tue kujtuom për kat porsī njani burë o jetëra gruo, qi kurajtë të ginë nukë di (XXII/2a)*.

<sup>8</sup> Gj. Shkurtaç, *Ligjërimet arbëreshe*, Tiranë, 2006, 207.

*Anakreontit / Ronej Tēmp e moçēme; E u pruar t' ikēnej; Shkonej vajza mespurtek; Vucën ajo ngrēnej.* Edhe kjo formë është e gjallë sot në krahinat e Jugut të Shqipërisë, sidomos në të folmen çame; p.sh.: *edhe rronej mirë me gja.* Foljet ndihmëse De Rada i përdor me trajta të sinkopuara; p.sh., *Vreshtat in të verdhullore; doin e kīn të bëjin.* Trajta të tilla gjenden në disa të folme gege, sidomos në anët e Malësisë<sup>9</sup>. Në të kryerën e thjeshtë, trajta e krijuar me anë të tkurrjes në vetën e dytë është shtrirë edhe në vetën e parë; p.sh. *Bardhullore u më e pē.* Kjo trajtë është popullore në të gjitha të folmet arbëreshe<sup>10</sup>; madje, ajo gjendet edhe te shkrimtarët e vjetër të Veriut. Interes paraqet edhe folja *vete*, që përdoret me mbaresën *-te* edhe në të kryerën e thjeshtë, ashtu si në disa të folme të Jugut të Shqipërisë; p.sh. *Nd'uj një ditë vate te mali*<sup>11</sup>. Në format e së kryerës së thjeshtë përdoret shpesh bashkëtingëllorja *-t*, si një mbaresë dytësore; p.sh. *Sbardhëtin anīzit, Ruatin pranë u shegëtin; muartin frënt e zaljevet; e porsitëtin të të ndërrōnj.* Trajatat e së ardhshmes, ashtu si në të gjitha të folmet arbëreshe, janë të formuara me foljen ndihmëse *kam* dhe me lidhoren; si p.sh. *Kā të niset e magjepsur?; E pse kē t'e thuash?* Kjo formë që del edhe te autori i parë i letërsisë arbëreshe, Lekë Matrënga, nuk përdoret përkëtej Adriatikut, me përjashtim të ndonjë gjurme në Bregdetin e Poshtëm. Ndërmjet formave të pashtjelluara, vërehet edhe ndonjë rast i përdorimit të paskajores gege me pjesëzën *me*; p.sh. *mēnōj ca hēr me rruar.* Përdorimi i kësaj trajte, në një të folme që ka si bazë dialektin jugor, e ka burimin në përzierjen e elementit të emigruar kryesisht nga Jugu me grupe nga krahinat veriore. Përcjellorja shfaqet me tre formante të ndryshme: *tuke, tue* e *ture*; p.sh., *djalin tuke ninulur të sëmurēm; tue mbjedhur tërkuzën; Prā të vëhej ture tjërr.* Nga këto, pjesëza *tuke* i përket dialektit toskë, *tue* është e dialektit gegë, kurse *ture* është një risi e të folmeve arbëreshe.

Ndër pjesët e paeptueshme, parafjalët *ndë, mbë* kanë ruajtur formën e tyre të vjetër, ashtu siç i ka edhe Buzuku e shkrimtarët të tjerë pas tij; p.sh. *Ndë çerët e dhezurës; Fjisin, se ndë vatëret s'in të j'atërat e vrëret; Kallëzoret mbë dhemat mbajn kangjele.* Formën e saj më të vjetër ruan edhe pjesëza mohuese *së*; p.sh. *Së leu ndër të mundasha; Së doi t'ikēnej.*

Me interes të veçantë gjuhësor janë edhe zhvillimet në fushën e sintaksës. Ka ndërtime e struktura të vjetra, që janë zhdukur ose janë në rrugën e zhdukjes në shqipen e sotme, por kanë qenë të pranishme në shqipen e lashtë. Nga këto vëmë në dukje përdorimin e rrjedhore pa parafjalë; si p.sh.

<sup>9</sup> Khs. në rapsoditë e Veriut: *kin çetinat vetëm kreshtat; In bucelat plot raki, / in fuçijat plot me venë.*

<sup>10</sup> La Piana, *Studi linguistici albanesi*, Varia, Palermo, 1949, 86.

<sup>11</sup> Khs. në Çamëri: *edhe ashtu vate plaka* (Pedersen).

*Mua më zëgjoi tue fjeturuar qelqevet finestërës; Dielli i sqepur reshit. Me rasën rrjedhore përdoret edhe parafjala për; p.sh. Më rëmpeftë për dorje; Si garaa çë del për sish. Në shqipen e sotme këtij përdorimi i ka mbetur vetëm ndonjë gjurmë në të folme dialektore (khs. në geg. VP: e kapi për dore, i doli për hundësh). Në veprën e De Radës gjejmë të përdorur gjithashtu një emër pa parafjalë për të shprehur një rrethanor vendi; p.sh. Vet Fjokat u m'u hjimisa; Kur jesh djāl e Salonik vajta; Po ndë javet vemi Art<sup>12</sup>. Kemi të bëjmë me një tipar të lashtë, që dëshmohet në gjuhët më të vjetra; khs. lat. *Eo Romam*. Në ndonjë rast lakohet mbiemri së bashku me emrin që ka përpara; p.sh. *Deljet ona u kīn gapur / Ljumraret të kaljthërve*. Raste të tilla të lakimit të dy gjymtyrëve të togfjalëshit gjenden edhe tek shkrimtarët e vjetër e aty-këtu nëpër të folme dialektore; p.sh. te Buzuku: *ata lanë Zotnë e ujënave gjallave*; Bogdani *themeli i gjithë vepërave mirave*; në folklor: *Kur ka dalë m'bjeshkën ma t'naltën*.*

Për përdorimin e nyjave janë për t'u vënë në dukje dy raste me rëndësi për historinë e gjuhës shqipe. De Rada përdor më shpesh se në shqipen e sotme të ashtuquajturën një pronore me emrat e farefisnisë, sidomos në numrin shumës; p.sh. *se ndë vatërët / S'īn të j'atërat e vrërët; te i emti ndë Pëllast*. Rasti tjetër është përdorimi i nyjës së përparme përpara emrave etnikë; p.sh. *Po nd'ān streksi një i Arbresh*, të cilin e kanë gjithashtu autorët e vjetër; p.sh., te Bardhi: *I katundas*; te Bogdani: *të gjytetasitë*<sup>13</sup>.

De Rada përdor shpesh dhanoren etike, një formë përemërore që tregon afërsi; p.sh. *Mos më jē ti e dheut guaj?*; *Kā bāllt u më ja e reshta*; *Mē ja e vū ndē dorjet*; *E më j'u duk i jati*. Për përemrat pronorë, është për t'u vërejtur përdorimi i shpeshtë i tyre në pozicion para emrit; p.sh. *itē vēllā erdh me dhëntërrin*; *Po jot motër martoghet*; *Ahier īn-zot i njomur prori*; *i biri t'īn zoti*. Disa prej këtyre përemrave e kanë ruajtur trajtën më të hershme të pronorit me zanoren -ē (khs. inē), e cila përgjithësisht ka rënë për hir të pozicionit të patheksuar në të cilin del përemri në sintagmat me një emër pas.

Interes të veçantë paraqesin edhe disa ndërtime të vjetra me karakter popullor, me parataksë në vend të hipotaksës, që përdoret në shqipen e sotme; p.sh. *Ç'është e ikën si ajri?* Edhe ky është një tipar i shqipes së lashtë, gjurmët e së cilës i gjejmë të shkrimtarët e vjetër e në të folme dialektore; si p.sh.: te Budi: *E prifti mbet e j tha*; në rapsoditë e Veriut: *me shpata kanë nisë e po priten*; *Ça ka qitun e ka thanë*. Formën e mënyrës lidhore të foljes, në sintagma me një folje tjetër, De Rada e përdor shpesh pa pjesëzën të; p.sh. *e s'kam vinj më*; *Dua vete mbë kjish*. Së fundi, vëmë në dukje një rast të veçantë në rendin e fjalëve në ndërtimet foljore me mënyrën urdhërore dhe

<sup>12</sup> Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe* (dispencë), Tiranë, 1967, 43.

<sup>13</sup> E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*; "Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 3, 1963, 75.

trajtat e shkurtra të përemrave; si p.sh. *Thomnie ju të dashurit; po mbamnie se jasht m'e vrasën*. Këtu kemi dy trajta përemërore, që ndahen nga njëra-tjetra nga mbaresa foljore (*tho-më-ni-e, mba-më-ni-e*), ndryshe nga shqipja e sotme, ku trajtat e shkurtëra të bashkuara vendosen përgjithësisht para mbaresës; por trajta të tilla, si ato të De Radës, gjenden në nëndialektin çam<sup>14</sup>.

Si përfundim, mund të thuhet se veprat e De Radës kanë ruajtur mjaft tipare arkaike, që janë mënjanuar në shqipen e sotme. Në veprat e tij gjejmë të folmen e vendlindjes së poetit, në një vështrim më të gjerë, dialektin arbëresh, që në shumë aspekte është arkaik dhe ruan karakteristika të shqipes mesjetare. Por krahas këtyre dukurive me karakter arkaik, në veprën e tij gjenden edhe disa risi, që u përkasin të folmeve arbëreshe. Për të gjitha këto veprat e poetit të madh të Makit kanë një rëndësi të veçantë për kërkimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe.

## BIBLIOGRAFI

- Bardhi, F., *Franciscus Blancus, Dictionarium latino-epiroticum*. Romae, 1635 (Dict.).
- Bogdani, P., *Cuneus Prophetarum*. Patavii, 1685.
- Budi, P., *Dottrina Christiana*. Roma, 1618.
- Budi, P., *Rituale Romanum*. Roma, 1621.
- Budi, P., *Speculum Confessionis*. Roma, 1621.
- Buzuku, Gj., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku*. Riproduzione e trascrizione di Namik Ressuli. Città del Vaticano. 1958.
- Buzuku, Gj., *"Meshari" i Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej. Pjesa e parë: Hyrje dhe transliterim. Pjesa e dytë: Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë, 1968.
- Çabej, E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*; në "Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore". Tiranë; 3, 1963.
- Çabej, E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1967.
- Çabej, E., *Histori gjuhësore dhe strukturore dialektore e arbërishtes së Italisë*. SF 2, 1975.
- Çabej, E., *Në botën e arbëreshëve të Italisë*. Tiranë, 1987.
- De Rada, G., *Poesie albanesi del secolo XV - Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari*. Napoli, 1836.

<sup>14</sup> Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, DS II 1974, 13.

- De Rada, G., *Grammatica della lingua albanese*. Prima parte. Firenze, 1871.
- De Rada, G., *Skanderbeku i pafân. Storie del secolo XV*. Libro II. Coriliano Calabro, 1873.
- De Rada, G., *Poesie albanesi*. Vol. II. Uno specchio di umano transito. Napoli, 1897 (Serafina Topia).
- De Rada, G., *I canti premilosaici*. Edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari. Catanzaro, 1998.
- De Rada, G., *Opera omnia X. Opere grammaticali*. Catanzaro, 2007.
- Demiraj, Sh., *Historia e gjuhës së shkruar shqipe* (dispencë). Tiranë, 1967.
- Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986.
- Folklor shqiptar II. Epika legjendare*. Vëllimi i parë. Tiranë, 1966.
- Haxhihasani, Q., *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*. DS II 1974.
- La Piana, M., *Studi linguistici albanesi*. Varia. Palermo, 1949.
- Matranga, L., *E mbsuame e chræsteræ* (dorëshkrimi I). Roma, 1592.
- Matranga, L., *E mbsuame e krështerë*. A cura di Matteo Mandalà. Caltanissetta, 2004.
- Pedersen, H., *Albanesische Texte mit Glossar*. Leipzig, 1895.
- Shkurtaç, Gj., *Ligjërimet arbëreshe*. Tiranë, 2006.
- Topalli, K., *Forme grammaticali e costruzioni arcaiche nell'opera di De Rada; "Omaggio a Girolamo de Rada"*, Atti del V Seminario internazionale di Studi Italo-Albanesi (2-5 ottobre 2003) e altri contributi albanologici. A cura di Francesco Altimari e Emilia Conforti. Università della Calabria. Rende, 2008.
- Topalli, K., *Kontributi i veprave të De Radës për historinë e gjuhës shqipe; "Buletin Shkencor"*, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 55, 2005.
- Topalli, K., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2010.

## SUMMARY

### ARCAIC ELEMENTS IN THE WORK OF DE RADA

De Rada is the greatest arbëresh poet and one of the classical of Albanian literature. His work is of valuable contribution in relation to Albanian history as well. He utilizes archaic words with great interest for their etymology. From a phonetic point of view, the poet reveals dialectal traits found in regions where Albanian is spoken, especially in Arbëresh dialect as well as in other regions, especially the southern ones. Of particular interest are some

grammatical forms, which have existed in an early stage of Albanian language and are stored in the work of the great arbëresh poet. These archaic grammatical forms are also found in the works of other old authors; therefore, a comparative study among them helps to sketch the general framework of the development of Albanian in the earliest period of its development.